

Gjatë kursit mësohet krijimi i filmit të vizatuar, shfaqjes me përmbajtje dhe fotografi, krijimi i ndërveprimit me përdoruesin dhe publikimi i filmit në faqe të uebit. Dituria e vetme paraprake e nevojshme është përdorimi i kompjuterit dhe i njërit nga sistemet drejtuese me ndërfaqe grafike, sikur Windows.

Përshkrimi i kursit

Hyrje

- Çka është Adobe Flash
- Si shfaqet filmi në ekran
- Dallimi nga imazhi me pikëza dhe imazhi vektorial
- Rezolucioni dhe madhësia e filmit

Pullat

- Krijimi i pullës
- Përdorimi i pullës për të hapur kuadrin
- Përdorimi i pullës për hapje të sajtit
- Përdorimi i pullës për e-postë

Sipërfaqja e punës

- Menyja dhe pajisjet e punës
- Vija kohore
- Mjetet ndihmëse: rrjeti, vizorja, vijat
- Mjetet e vizatimit
- Shtresat dhe si përdoren ato

Ngarkimi i tekstit nga dokumenti i jashtëm

- Sqarim i Actionscript-it
- Krijimi i dokumentit të tekstit
- Krijimi i skriptit për ngarkim
- Krijimi i fushës dinamike
- Ngarkimi i tekstit prej fillimit të filmit
- Ngarkimi i tekstit me pullë
- Krijimi i ndryshoreve për pjesë të tekstit

Krijimi i filmit

- Vizatimi me pajisjet nga Flash
- Importimi i artit vektorial nga programet tjera të vizatimit
- Importimi i fotografisë
- Krijimi i filmit kuadër për kuadër
- Krijimi me Motion Tween
- Krijimi me Shape Tween

Eksportimi i filmit për faqe të uebit

- Sqarim i shfaqjes në faqe të uebit
- Mundësitë e publikimit në ueb

Simbolet dhe biblioteka

- Sqarim i simboleve
- Krijimi i simboleve
- Përdorimi i simboleve në skenë

Efektet e posaçme

- Krijimi i përqindjes së ngarkimit
- Krijimi i albumit me fotografi
- Krijimi i ndërveprimit me përdoruesin
- Krijimi i shfaqjes sikur me PowerPoint
- Ngarkimi i imazheve nga jashtë
- Krijimi i provimit me pyetje

Gjatë kursit pjesëmarrësit ushtrojnë me detyra praktike. Ata marrin nga ne udhëzimet me shkrim në gjuhën shqipe, mirëpo librat, **tani për tani**, për këtë kurs janë ende vetëm në gjuhën angleze ose holandeze. Të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtë përkrahje pa pagesë përmes postës elektronike.

Për të gjitha efektet e posaçme i kemi shkruar shqip mësimin për të gjitha shkallët e diturisë.

Për hollësi kontaktoni në adresën info@studiotuerta.com ose vizitoni sajtin www.studiotuerta.com.